

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMINE SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE  
PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**Objekti i prokurimit: ``Rikonstruksion i rrugës ``Bylbyl Breçani`` fshatit Markaj, Bashkia Tropojë ``**

**Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (CPV):45210000-2, Punime ndërtimi.**

**Vlera e fondit limit: 54502005 (pesdhjetekatërmiljon e pesqind e dymijepese) lekë pa TVSH.**

Në bazë të Nenit 21, pika 2, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”; Nenit 2, pika 2/c si dhe Nenit 78, pika 2, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,Autoriteti Kontraktor,Bashkia Tropojë,ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

**1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:**

- a. *Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;*
- b. *Listat e Çmimeve sipas zërave të preventivit sipas Shtojcë 2*
- c. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*
- d. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;*
- e. *Vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotesimin e formularit te vetedeklarimit, dokumentet perkatese vertetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika7, gërma “ç” (sipas Shtojcës 1 te DST).

**c.Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;**

**d.Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme për sigurimin e ofertës mbështetet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 83, pika 1 si dhe nëVKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni II, Neni 30, pika 1.

Kërkesa për Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimitbazohet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 82 si dhe nëVKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,Kreu V, Seksioni II,Neni 26.

**d. Vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotesimin e formularit te vetedeklarimit,dokumentet perkatese vertetuese do të paraqiten ngaoperatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 7, gërma “a”.

## **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

### **2.1. Përshatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

#### **Sipas Shtojcës 7 të DST**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në Nenin 77, pika 1/a dhe pika 2, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; si dhe Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

### **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

1. Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kopje të çertifikuara të bilanceve të 3 (tri) viteve të fundit financiare (2019, 2020, 2021) të paraqitur në Autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky Autoritet si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit).

*Shëmin: Akt Ekspertizë e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabel ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabel, **për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm:** i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabel përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabel arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabel”.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; si dhe Kreu V, Seksioni III, Neni 43, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligjit Nr.10091 date 5.3.2009 “Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”(i ndryshuar).

1. Kopje të deklaratimit të xhiros vjetore gjatë 3 (tri) viteve të fundit financiare (2019, 2020, 2021) lëshuar nga Autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës që po prokurohet konkretisht: **54 502 005.46** (pesdhjetekatermiljon e pesqind e dymijepesepikedyzetegjashte)lekë pa TVSH.

- 1.1 **Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në Kreun V, Seksioni III, Neni 43, pika 2 dhe pika 3 e VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Kërkesat e renditura sipas Kapacitetit ekonomik dhe financiar (pika 1 dhe pika 2) i shërbejnë Autoritetit Kontraktor, për të provuar nëse Ofertuesit zotërojnë kapacitetin financiar për të përmbushur me sukses kontratën objekt prokurimi.

2. Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2021 dhe për vitin 2022 sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, (i ndryshuar). Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB. *(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotesimin e formularit të vetedeklarimit, dokumentet përkatëse vërtetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).*

**2.2 Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar sipas Nenit 76 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; Kreut V, Seksioni III, Nenin 43, pika 6të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” si dhe sipas Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar). Duke qenë se Autoriteti Kontraktor, Bashkia Tropoje, është njësi e vetëqeverisjes vendore, e cila funksionon dhe ka kompetenca të përcaktuara sipas Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Njësia e Prokurimit argumenton se pika 3 është vendosur në kuadër të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar), Neni 5, gërma “c” ku citohet se: “...përcakton numrin e kësteve të pagimit të taksës dhe afatet e kryerjes së tyre, si dhe kushtet lehtësuese në rastet e pagesës së plotë dhe përpara afateve të detyrimeve fiskale”.

### **Kapaciteti teknik:**

**Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:**

#### **1. Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:**

Plotesimi i njerit prej dy kushteve të siperpërmendura e ben oferten te kualifikueshme.

- a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlloritur të kontratës që prokurohet konkretisht: **27 251 002.5** (njeteshtatemiljon e dyqind epesdhjet enjemijeedypikpese) lekë pa TVSH, të realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.
- b. Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit është në një vlerë jo më të vogël sa dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet konkretisht: **109 004 010** ( njeqindenedemiljonekatermijeedhete ) lekë pa TVSH

*Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

*Në rastin kur Operatorët ekonomik, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në Kontratën e Bashkëpunimit se cili prej tyre do ta përmbushë këtë kusht.*

**1.2 Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:**

- a) Për kontrata të realizuara me ente publike, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Formular vleresimi per realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9 (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i perfundimit te kontrates si dhe natyra e punes se kryer);
  - Kontratë Sipërmarrje;
  - Situacionin përfundimtar;
  - Aktin e kolaudimit;
  - Çertifikaten e marrjes ne dorezim/Çertifikatën e Përkohshme të marrjes ne dorezim.
- b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
- Formular vleresimi per realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9 (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i perfundimit te kontrates si dhe natyra e punes se kryer);
  - Kontrate Sipërmarrje;
  - Situacionin përfundimtar;
  - Aktin e kolaudimit;
  - Çertifikaten e marrjes ne dorezim/ Çertifikatën e Përkohshme të marrjes ne dorezim;
  - Fatura tatimore perkatese.
- 1.3 Per kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë: Kontraten e Bashkimit te operatoreve ekonomik si dhe prokuren e posacme te deklaruar ne fazen e tenderimit.
- 1.4 Për kontratat e realizuara si nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë: kontratën baze ndermjet kontraktorit dhe autoritetit kontraktor, kontraten e nenkontraktimit dhe aktin emiratimit zyrtar si nenkontraktor.

**Argumentimi:** Përvoja e sukseshme si dhe vlerësimi i saj u hartua duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe bazuar ne Nenin 39, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që Operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanëpërvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që:

- a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë jo me te vogel se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet konkretisht: **27 251 002.5** (njeteshtatemiljon e dyqind epesdhjet enjemijeedypikpese) lekë pa TVSH, të realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates.
- b. Punë të ngjashme deri ne nje kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit është në një vlerë jo me te vogel sa dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet konkretisht: **109 004 010** ( njeqindenedemiljonekatermijeedhete ) lekë pa TVSH

Plotesimi i njerit prej dy kushteve te siperpermendura e ben oferten te kualifikueshme.

*Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

*Në rastin kur Operatorët ekonomik, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në Kontratën e Bashkëpunimit se cili prej tyre do ta përmbushë këtë kusht.*

Gjithashtu referuar VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, Kreu XI, Neni 88, pika 3 citohet se: “Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.”AK argumenton se Puna e ngjashme është

kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve. Vlerësimi i përvojës realizohet duke paraqitur dokumentat e kërkuara sipas pikave (1.2-1.4), të cilat vërtetojnë eksperiencën në realizimin e punëve publike të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.

Përvoja e sukseshme si dhe vlerësimi i saj është hartuar duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” ku qartazi përcaktohet se: *”Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.*

*Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.*

*Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përkthyer nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”, si dhe bazuar në Nenin 39, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se: *”Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës; b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme. Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.”.**

AK argumenton se Puna e ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve. Vlerësimi i përvojës realizohet duke paraqitur dokumentat e kërkuara sipas pikave 1.3 dhe 1.4, të cilat vërtetojnë eksperiencën në realizimin e punëve publike të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi. Sqarojmë se nga praktika, gjatë fazes së vlerësimit të ofertave, AK ka hasur vështirësi në vlerësimin në mënyrë sa me të drejte të përvojës së ngjashme, pasi jo të gjitha institucionet shtetërore apo private leshojnë Formularin e Vlerësimit sipas formatit zyrtar (ku përcaktohet ndarja e përqindjeve). Në kuadër të vlerësimit të ofertave në mënyrë sa me të drejte, duhet që në rastet e BOE apo Nenkontraktim, vlerësimi i përvojës të vërtetohet me paraqitjen e kontratës së bashkëpunimit; me marrëveshjen e nenkontraktimit si dhe me aktin e miratimit të nenkontraktimit leshuar nga Institucioni. Ky dokumentacion disponohet nga çdo OE si në rastin kur ka qene pale në Bashkimin e OE ashtu dhe në rastet kur ka qene Nënkontraktor. Ky dokumentacion është lehtësisht i aksesueshëm dhe është pjesë e dosjes së zbatimit të punimeve të kontratës që duhet ta ketë çdo kompani në dosjen e saj, për rrjedhojë nuk mund të sjellë kufizim të pjesëmarrjes së OE në tender as në mënyrë direkte dhe as në mënyrë indirekte.

Gjykojmë që kërkesa e mësipërme nuk është në kundërshtim me asnjë nga dispozitat ligjore që parashikon legjislacioni i prokurimit publik.

Gjithashtu vendos në kushte të barabarta dhe u jep mundësi të gjithë OE Ofertues edhe në ato rastet kur Formularët e Vlerësimit mund të jene të paplotesuara sipas standartit.

AK ka kërkuar këto dokumenta në përputhje me parashikimet e Nenit 39, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, ku ndër të tjera përcaktohet se: *”Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe*

*natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.”.*

## **1. Liçensa profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës:**

Operatori Ekonomik duhet të disponojë Liçencë të shoqërisë e vlefshme për kategoritë e mëposhtme:

### **Punime të Përgjithshme Ndërtimi**

- NP.1 A Punime gjurmimi në tokë
- NP.4 B Rruge autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale
- NP-7 A Ujësjiellës, kanalizime, vepra kullimi e vaditje
- NP.11 A Ndërtime për nënstacionet, kabinat e transformatorëve, linja e tensionit të lartë e të mëme dhe shpërndarjen e energjisë.
- NP.12 A Punime të inxhinierisë së mjedisit

### **Punime Speciale Ndërtimi:**

- N.S-1 A Punime për prishjen e ndërtimeve
- N.S-6 A Sinjalistike rrugore jo ndricuese
- N.S 18 A Punime topogjeodezike

sipas modelit të lëshuar nga institucioni përgjegjës për dhënien e licensave profesionale sipas legjislacionit në fuqi.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 77, pika 1 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”; Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6/a, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Klasifikimi i shoqërive ndërtimore sipas niveleve për çdo kategori punimesh zbatimi i referohet Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”.

Kategoritë e licensave “N.P dhe N.S” të përcaktuara në pikën 2 të kriterëve të vecanta të kualifikimit, kapaciteti teknik janë hartuar në përputhje me zërat konkret të punës që përmban preventivi i punimeve. Me qëllim realizimin e punës objekt prokurimi, është kërkuar që Ofertuesit të jenë të pajisur me Liçencë profesionale për këto kategori si dhe të disponojë nënkategoritë sipas gjurmave që parashikohen nga legjislacioni përkatës. Përcaktimi i nënkategorive është vendosur nga mbledhja e vlerave të secilit volum pune, mbështetur në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, ku janë përcaktuar kategoritë dhe nënkategoritë përkatëse. Kjo kërkesë është vendosur nga Autoriteti Kontraktor me qëllim shqyrtimin e kualifikimit profesional të Ofertuesve në kuadër të veprimtarisë tregtare objekt prokurimi.

2. Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, të figurojë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtme:

- a) Librezë pune;
- b) Kontratë pune e vlefshme;
- c) Diplomë.

*(Ne rastin e Bashkimit të Operatoreve Ekonomik secili Operator duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që*

*do te kryhen punimet ne objekt ne varesi te vleres se preventivit te punimeve qe ka marre persiper sipas pergjindjes se bashkepunimit).*

**Argumentimi:** *Së pari*, kjo kërkesë mbështetet ne Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik si numri i inxhinierëve të ndërtim, elektroteknik, mjedisi, hidroteknik, topograf, gjeolog, arkitekt është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtuesi i teknik është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij **drejtues teknik** të cilët kanë një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e punimeve pasi ata janë përgjegjës për zbatimin e objektit sipas projektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit të tij.

Kërkesa specifike për Inxhinierët e kërkuar është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve (nga ku përcaktohet qartazi dhe profili inxhinierik) si dhe në bashkërendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës 2.3, kapaciteti teknik në DST. Duke marrë në konsideratë Projektin e zbatimit si dhe Preventivin e Punimeve rezulton se është e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit Inxhinierë të kërkuar sipas pikës 2.4, të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin ,stafin mbështetes si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi.

- Referuar në preventivin e Punimeve si dhe në bashkërendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës **NP4, NP2, NP5, NS1, NS4, NS9** eshte e nevojshme prezenca e **Inxhinierit të Ndërtimit**.
- Referuar në preventivin e Punimeve si dhe në bashkërendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës **NP 11**, eshte e nevojshme prezenca e **Inxhinier Elektrik**.
- Referuar në preventivin e Punimeve si dhe në bashkërendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës **NS 18** eshte e nevojshme prezenca e një **Inxhinier Gjeodet/Topograf/**, pasi çdo matje që do të bëhet në funksion të objektit të prokurimit kërkon domosdoshmërisht praninë e këtij Inxhinieri.
- Referuar kategorisë së kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës **N.P. 12 – A** Punime të inxhinierisë mjedisore eshte e nevojshme prezenca e një **Inxhinier Mjedisi**.

3. Operatori ekonomik duhet te kete nje punesim mesatar minimumi **23 (njezetetre)** punonjes te vertetuar me: Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve minimumi per 3 (tre) muajt e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave dhe listpagesat perkatese të konfirmuara nga autoritetet përgjegjese, shoqëruar me formularët e deklarimit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore. (*Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit, dokumentet perkatese vertetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit*).

**Argumentimi:**Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “ç”.

Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Specifikimeve Teknike (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentat e Tenderit) si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës.

Nga ana teknike argumentojmë se numri mesatar i punonjësve, prej gjithsej **23** (*njezetetre*) punonjësish, është caktuar në bazë të llogaritjeve të zërave të punës dhe volumit përkatës të cdo zëri në preventiv si dhe grafikut në zbatim të punimeve, të cilat duhet të përfundojnë brenda 12 muajve kalendarikë nga data e nënshkrimit të kontratës, mbështetur kjo në VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre”. Nëpërmjet këtij kushti kërkohet që të vërtetohet se Ofertuesit zotërojnë kapacitetet e nevojshme teknike lidhur me stafin që kanë në dispozicion, si dhe shërbejnë për të provuar se kanë qëndrueshmëri të stafit pa shkëputje nga puna, dëshmi të cilat i japin garancitë e nevojshme Autoritetit Kontraktor mbi përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi. Numri i punëtorëve si dhe personeli i nevojshëm për zbatimin e kontratës është përcaktuar duke marrë në konsideratë vlerën e kontratës që prokurohet, natyrën si dhe kohëzgjatjen e saj si dhe duke u mbështetur mbi përvojën e mëparshme që ka pasur AK në zhvillimin e procedurave me objekt të ngjashëm dhe i shërben Autoritetit Kontraktor për t’u njohur me kapacitetet profesionale të ofertuesve me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

Gjithashtu për të vërtetuar zotërimin e fuqisë punëtore si dhe stabilitetin e saj është kërkuar edhe vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore si dhe listpagesat e punonjësve mbështetur edhe në Kreun V, Seksioni III, Neni 39, pika 8 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” sipas së cilës: *“Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”*.

4. Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, të perfshirë në licencën e shoqërisë, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, librezë pune, diplomë përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, konkretisht:

- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi
- 1 (një) Inxhinier Hidroteknik
- 1 (një) Inxhinier Elektrik
- 1 (një) Inxhinier Gjeodet/Topograf/Markshajder
- 1 (një) Inxhinier Mjedisi

**Argumentimi:** AK argumenton se kërkesa për stafin inxhinierik është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Kërkesa specifike për Inxhinierët e kërkuar është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve (nga ku përcaktohet qartazi dhe profili inxhinierik) si dhe në bashkëndim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës 2, kapaciteti teknik në DST. Duke marrë në konsideratë Projektin e zbatimit si dhe Preventivin e Punimeve rezulton se është e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit Inxhinierë të kërkuar sipas pikës 5, të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi.

5. Operatori/et ekonomik duhet të kenë në stafin e tyre personel të kualifikuar/çertifikuuar si:



- a. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë 1 (një) punonjës specialist që të disponojë certifikatë e trajnimit si "Për përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Per sigurine ne kantier", si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë të paktën 3 muajt e fundit .

**Argumentimi:** AK argumenton se kërkesa për 1 (një) *Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë*shtë vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", Neni 77, pika 4; të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma "c",si dhe në mbështetje të Nenit 7 të Ligjit Nr. 10237, datë 18.02.2010 „Për sigurinë dhe shëndetin në punë“, sipas të cilit: „Punëdhënësi ngarkon një ose disa punëmarës që të merren me çështjet e mbrojtjes, të sigurisë e shëndetit në punë.....“.

Theksojmë se, Autoriteti Kontraktor ka qëllim realizimin e kontratës objekt prokurimi sipas kushteve të përcaktuara në DST, duke respektuar çdo rregull lidhur me kantierin e ndërtimit si dhe me sigurinë e punonjësve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së punës. Është e rëndësishme që punimet të realizohen brenda një kantieri të sigurt duke mbrojtur jetën e punonjësve, por dhe të kalimtarëve që mund të jenë përreth vendit të punimeve. Për sa më lart, punonjësitte ciletjanë teçertifikuar si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë", nëpërmjet dijes dhe eksperiencës të fituar në këtë fushë, duhet të shmangin apo parandalojnë çdo rrezik që mund të shfaqet gjatë veprimtarisë së shoqërisë dhe që mund të çënojë shëndetin apo sigurinë në punë. Në këto kushte, vendosja e këtij kriteri shërben si një garanci që Ofertuesit do të reazlizojnë punimet sipas standarteve ligjore në fuqi.

6. Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik per kryerjen e punimeve, te vertetuar me kontratë punë te vlefshme, diplome leshuar nga autoritetet pergjegjese shteterore, dëshmi kualifikimi te sigurimit teknik (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për çertifikimin e punonjësve), si dhe te figurojne ne listpagesat e shoqërisë minimumi per periudhen e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave, si më poshtë:

- 1 punonjes teknik ndertimi
- 3 shofera
- 4 manorator
- 1 Punonjes elektrikist
- 1 Punonjes hidraulik
- 7 sp + puntor

- Për stafin teknik, ofertuesi duhet të paraqesë :

- Kontratë individuale të punës te vlefshme;
- Diplomë që të vërtetojë kualifikimin profesional të mësipërm;
- Çertifikate e sigurimit Teknik e vlefshme, leshuar nga institucione te autorizuar nga /ish (IQT), e cila duhet te jete e leshuar nga shoqeri te akredituara nga DPA ose nga organizmat nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise.

- Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë per punonjesit teknik ndertimi, elektrikist dhe hidraulik, emrin/mbiemer, profilin e punes, numrin e kontratës individuale të punës, numrin dhe titullin e kualifikimit per diplomën përkatëse, si dhe institucionin që ka leshuar këtë dokument.

- Për punonjesit manovrator/shofer, ofertuesi duhet të paraqesë:

- kontratën individuale të punës te vlefshme;

- leje drejtimi, certifikate e aftësisë profesionale/Patente Manovrimi nga DPSHTRR.Në rastin kur punonjësit manovrator/shofere janë të kontraktuar me kontratë pune, respektivisht për mjetet e marra me qera, nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë).

-Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë për punonjësit manovratorë, emrin/mbiemer, profilin e punes, numrin e kontratës individuale të punës, si dhe numrin e deshmise së aftësisë profesionale.

**Argumentimi:** Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4; në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Specifikimeve Teknike (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentat e Tenderit) si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës. Sqarohet se, të gjithë specialistët e kërkuar janë në përputhje të plotë me projekt-preventivin duke marrë në konsideratë volumet e punes që do të realizohen, si dhe kohëzgjatjen e tyre. Autoriteti Kontraktor domosdoshmërisht duhet të garantohet që këto punime do të kryhen nga persona të kualifikuar dhe me eksperiencë të mjaftueshme, për zbatimin e këtyre punimeve sipas standarteve të përcaktuara në specifikimet teknike. Për të vërtetuar kualifikimin e stafit teknik është kërkuar që të jenë të pajisur me diplomë/dëshmi përkatëse lëshuar nga institucione të akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik. Certifikimet /diplomat profesionale duhet të jenë të lëshuara nga institucione të licensuara nga organet përkatëse, mbështetur në Ligjin Nr. 15/2017 “PËR ARSIMIN DHE FORMIMIN PROFESIONAL NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË” Mbështetur në këtë legjislacion certifikimet profesionale ofrohen nga institucione të licensuara nga Ministria përkatëse nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional. Certifikatat e këtyre specialisteve duhet të jenë të regjistruara në “rregjistrat profesionale” të AKAFP-se.

Makineritë e rënda të ndërtimit dhe emërtimet bëhen sipas Dëshmive të Aftësive Profesionale (DAP), të cilat ndahen si më poshtë :

- a) eskavator gjurmimi e ngarkimi dherash : të gjitha llojeve si dhe fadromat e të gjitha llojeve (me goma dhe me zinxhirë), manovratorëve u jepet dëshmi për **Eskavatorist**;
- b) buldozer gjurmimi, shtyrje, nivelimi e ngjeshje dherash apo shpim toke : të gjithë llojet e traktorëve me thikë (ruspë), ose që tërheqin skreper, grejder apo nivelues, rul vibrues, shtruese asfalto-betoni, skreperët, grejderët dhe niveluesit kur janë vetëlëvizës, të gjithë llojet e traktorëve, me pajisje shtesë për ngritjen e peshave, shpimin e puseve etj., manovratorëve u jepet dëshmi për **Buldozerist**.
- c) automjete për përdorim të veçantë (APV) sipas pikës “g”, të nenit 54, të Kodit Rrugor, makineri ndërtimi mbi bazë automjeti : autovinça, autobetonierë, autopompa betoni, autobitumatriçe, autosonda, autotokmak, manovratorëve u jepet dëshmi për **Automakinist**.

7. Operatori ekonomik duhet paraqesë një CV të shoqërisë ku të pasqyrohen të gjitha punët e realizuara gjatë aktivitetit të tij dhe listë të personelit, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit. Lista e personelit të kërkuar duhet të përfshijë dhe CV-të e tyre.

**Argumentimi:** AK argumenton se kërkesa për *specialistin Ekspert Zjarrfikës* është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4; të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

8. Operatori ekonomik duhet të paraqesë grafikun e punimeve të detajuar sipas zërave të preventivit (Bashkëlidhur DST) të shprehur në afatin kohor të përcaktuar në dokumentat e tenderit për **9 (nende) muaj** kalendarike.
9. Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat si më poshtë:
- Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015 (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO9001:2015)
  - Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 14001-2015(e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO 14001-2015.
  - Çertifikatën e menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit ISO 45001-2018, (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO 45001-2018.

**Argumentim:** Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sipas pikës 14 gërma “a”- “e” janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni79, pika 1 ku citohet se: *“Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”*,si dhe ne zbatim te Neni 44, pika 1 dhe pika 3 tëVKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,ku përcaktohet se:*“Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”*.

AK gjykon se kërkesa për pajisjen e Ofertuesve me Çertifikatat e kërkuara sipas pikës 14 gërma “a”- “d”, është brenda kuadrit të parashikuar nga legjislacioni për prokurimin publik. Çertifikatat e kërkuara janë në përpjestim me objektin e kontratës dhe respektojnë natyrën e punimeve.

10. Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 8) konkretisht:

Mjetet	Sasia	Gjendja
Kamion me kapacitet mbajtës minimalisht 10 ton dhe jo me shume se 20 ton	2 copë	Pronësi ose me qera
Kamion me kapacitet mbajtës minimalisht 10 ton	1 copë	Pronësi ose me qera
Eskavator 0.25 m3	1 copë	Pronësi ose me qera
Eskavator 0.50 m3	1 copë	Pronësi ose me qera

Autovinç 0.5 ton	1 cope	Pronësi ose me qera
Rrul me vibrim	1 copë	Pronësi ose me qera
Rrul me kompresor	1 copë	Pronësi ose me qera
Autobot Uji	1 copë	Pronësi ose me qera
Grejder	1 copë	Pronësi ose me qera
Autobitumatrice	1 copë	Pronësi ose me qera
Asfaltoshtruese	1 copë	Pronësi ose me qera
Fadrome me goma	1 copë	Pronësi ose me qera
Betonjere	1 cope	Pronësi ose me qera
Vibrator	1 cope	Pronësi ose me qera
Sperkatese Boje(Makin Vizimi)		1 cope

**a)** Përmjetet në pronësi duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë); b) leje qarkullimi; c) çertifikate e kontrollit teknik (e vlefshme); d) siguracion mjeti (i vlefshëm); e) çertifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme).

**b)** Për mjetet e deklaruara me qera duhet të paraqitet: a) kontrata përkatëse noteriale e qerasë e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi b) dokumenti që verteton regjistrimin e tij (akti i pronësisë) c) leje qarkullimi; ç) çertifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme) d) siguracion mjeti (i vlefshëm); e) çertifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme).

**c)** Për mjetet e deklaruara që transportojnë mallra të klasifikuara sipas legjislacionit në fuqi të rrezikshme, duhet të paraqitet çertifikatë për transport mallrash të rrezikshëm lëshuar nga institucionet përkatëse (e vlefshme).

**d)** Për pajisjet teknike, të cilat janë në pronësi të operatorit ekonomik, duhet të paraqitet kontrata e shitblerjes/fatura tatimore e shitjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes ndërsa kur janë të marra me qera duhet të paraqitet kontrata e qerasë, fatura tatimore e shitjes/ kontrata e shitblerjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes. Në rastin kur fatura është lëshuar nga subjekte që nuk janë të regjistruar si tatimpagues të TVSH-së duhet të shoqërohet me kuponin tatimor.

**e)** Për mjetet dhe pajisjet teknike që ka deklaruar operatori ekonomik duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet dhe pajisje. Në rastin e mjeteve të treguara duhet të jetë e dukshme në një foto të vetme mjeti dhe targa e tij.

**13.1** Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me anë të së cilës pranon verifikimin e mjeteve dhe pajisjeve të deklaruara në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës nga Autoriteti Kontraktor.

**13.2** Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës deklaron se mjetet dhe pajisjet e deklaruara nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruara në procedurat të shpallura fitues nga Autoriteti Kontraktor, Bashkia Tropoje.

**13.3** Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë për vendndodhjen e mjeteve në pronësi ose me qera me qëllim verifikimi nga Autoriteti Kontraktor.

**Argumentimi:** Kërkesa e mesiperme është vendosur sipas pikës 4, të Nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa ”d” të VKM Nr.

285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar). Nepermjet ketyre kerkesave, Operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që kanë në dispozicion apo që mund t’u vihen në dispozicion me qellim permbushjen me sukses te kontratës objekt prokurimi.

Për të përcaktuar llojin dhe numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, sipas zerave te preventivit dhe specifikimeve teknike te hartuara nga specialistet e fushes. Çdo mjet i kërkuar përkon me proceset ndërtimore sipas zërave përkatës të Preventivit. Numri i makinerive është përcaktuar duke marrë në konsideratë volumet e punimeve për secilin zë pune mbështetur kjo në VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre”. Dokumentacioni shoqërues i kërkuar për makineritë, provon certifikimin ligjor dhe teknik të mjeteve të disponuara nëpërmjet Kontratës së Shtitjes apo Kontratës së Qirasë. Ky dokumentacion i jep garanci Autoritetit Kontraktor se punimet do të realizohen me cilësi, siguri dhe në respektim të Grafikut të Punimeve (i cili do të publikohet së bashku me Dokumentat e Tenderit).

Çdo mjet i përcaktuar sa më sipër është kerkuar ne funksion te kryerjes se zerave specifike te punimeve, ndërsa numri i mjeteve është përcaktuar ne varesi te volumeve te punimeve përcakton se ofertuesit dhe rrjedhimisht fituesi i mundshëm të vërtetojë se zotëron kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike:**

### **Argumentimi i specifikimeve teknike**

**Shënim:** Në zbatim të pikës 1, të Nenit 26, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, sjellim ne vemendje se:

- Dokumentet perkatese vertetuese per disponimin e punonjësve do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

- Autoriteti/enti kontraktor perpara publikimit te njoftimit te fuesit do t’i kërkojë ofertuesit te kualifikuar nëpërmjet Sistemit të Prokurimit Elektronik që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet e bëra në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e tjera të paraqitura ne sistemin elektronik të prokurimit gjate fazës së ofertimit. Mosparaqitja e dokumentacionit të sipërcituar do te jete kusht s’kualifikimi.

- Autoriteti Kontraktor do te beje verifikimin e dokumentacionit ne perputhje me vetedeklarimet e bera në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Konstatimi i mosperputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit te dorezuar perben kusht s’kualifikimi.